



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 451/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Naser Pajaziti kandidatë për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Hudhet** si e pasafatshme ankesa e Naser Pajaziti, kandidat për deputet nga Aleanca Kosova e Re.

### Arsyetim

Me datë 28.06.2014 ora 15:15 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Naser Pajaziti kandidat nga subjekti politik AKR në të cilën ka pretenduar se në shumë qendra të votimeve në Kosovë i është vjedhur vota, si në Mitrovicë, Podujevë dhe Prizren.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

### ankesa është e pasafatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa në fjalë është e pasafatshme, pasi që neni 105.1 i LZP-së, parasheh që *“ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzet e katër (24) orësh nga ndodhja e shkëljes së supozuar. KQZ me datën 26.06.2014 në ora 15:00 ka bërë publikimin e rezultateve përfundimtare. Afati i paraparë për parashtrimin e ankesave në PZAP ka qenë prej 24 orëve nga momenti i publikimit të rezultateve përfundimtare, ndërsa ankesa në PZAP është dorëzuar me datën 28.06.2014 në ora 15:15, çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 24 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 105.1 dhe nenit 118.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

### Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtrësë

Anr. 451/2014 më datën 30.06.2014



Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha

**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*